

Avokimi për kthim dhe reintegrimit

Nën këtë projekt, partnerët lokalë Sfida, Jug dhe Humana me ndihmën e CRS-së do të organizojnë 18 grupe të bisedimeve, (fokus grupe) takime të shumta të udhëheqësve të bashkësive dhe një punëtori të tejkalimit të pengesave për të identifikuar dhe adresuar pengesat më të mëdha për kthimin e të zhvendosurve dhe të bashkësive të tyre të kthimit. Qëllimi i këtyre takimeve është përgatitja dhe prezantimi i planit të përbashkët të veprimit ndërmjet të zhvendosurve intern dhe rezidentëve nga ish bashkësitë e tyre në Grupin Punues të Komunës së Prizrenit. Qëllimi është rritja e pjesëmarrjes të këtyre popullatave dhe zvogëlimi i pengesave për t'u kthyer në të cilat pjesëmarrësit e lartpërmendur kërkojnë t'i definojnë. Përfundimisht, ky projekt përqendrohet në tri komunitete në Komunën e Prizrenit – qytetin e Prizrenit, Sërbicë të Epërme dhe Smaç.

Sesionet e Grupeve të përqendrimit

Gjatë muajit të janarit, Shërbimet Katolike për Ndihmë (CRS) dhe partnerët lokalë zhvilluan katër grupe të ndara të bisedimeve që u mbajtën në Serbi dhe në Kosovë. Ky projekt organizon 18 grupe të bisedimeve gjatë një periudhe tre mujore. Momentalisht, aktivitetet e projektit që u përkasin kthimeve në Prizren, Sërbicë të Epërme dhe Smaç po zhvillohen në Serbi dhe në Kosovë. Ato po punojnë me bashkësitë në Kosovë ku të kthyerit planifikojnë të kthehen dhe në Serbi ku të zhvendosurit internë kanë shprehur interesim për t'u kthyer në bashkësitë e tyre përkatëse në Kosovë.

U diskutuan temat si të zhvendosurit dhe shqetësimet dhe pengesat e bashkësive të kthyeras sikurse edhe standardet e parashtruara nga bashkësia ndërkombëtare:

-E drejta e pronës dhe e drejta e kthimit në Kosovë,

-Sigurimi i kushteve për kthim të sigurtë dhe reintegrimit të të zhvendosurve,

-E drejta e të zhvendosurve për të gjitha informatat që kanë të bëjnë me kthimin dhe fillimin e procesit të kthimit.

-Për më shumë, para grupeve të bisedimeve, partnerët lokalë në Serbi dhe në Kosovë zhvilluan dhe u pajtuan në lidhje me një strukturim të udhëzimeve të pyetjeve të grupeve të bisedimit në temat që vijojnë:

-Përbërja etnike në bashkësitë e tyre para dhe pas luftës,

-Përmirësimi i standardeve të jetesës në rajonin e Prizrenit,

-Bashkëjetesa me etnicitetet e tjera dhe rikrijimi i besimit,

-Identifikimi i pengesave për kthim dhe zgjidhjet e tyre,

-Bashkëpunimi ndërmjet të zhvendosurve dhe bashkësive të kthimit,

-Kriteri dhe tipet e udhëheqësve të bashkësive,

-Njohja e Grupit Punues të Komunës së Prizrenit (GPKP) dhe,

-Vetëdijësimi i ish pjesëtarëve të bashkësive që jetojnë jashtë Kosovës.

Në përgjithësi pjesëmarrësit e grupeve të bisedimit shprehën gatishmërinë e tyre për të punuar dhe për të sinkronizuar së bashku veprimet për zhvillimin e besimit të anasjelltë dhe krijimin e kushteve për kthimin e të zhvendosurve. Po ashtu, u theksuan edhe bashkëpunimi i mirë me Institucionet e Kosovës, UNMIK-un dhe OJQ-të.

Në veçanti, partneri lokal i CRS-së "Sfida", udhëhoqi një grup të bisedimeve në Prizren, Kosovë në të cilin morrën pjesë 13 pjesëtarë të komunitetit, prej të cilëve dy ishin femra dhe tre të rinjë. Kjo përfshinte 2 boshnjakë, 2 turqë, 2 romë dhe 7 shqiptarë. Pjesëtarët e bashkësive theksuan se punësimi ishte shqetësimi më i madh për ta dhe se UNMIK-u dhe Qeveria e Kosovës duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha në drejtim të privatizimit para se e tërë vëmendja e pjesëtarëve të bashkësive të përqendrohet në çështjet multietnike. Megjithatë,



Fotografia: "Mushnikove"-Autori i panjohur

Ekipi i projektit



Zyrja ne Prishtinë dhe ajo ne Beograd
Gostivarska 78 Belgrade—Dukagjini II 39/A Prishtina



Savnicka 41 Belgrade—humanabg@yubc.net



Ortakol, Prizren



Fourth Kraljevo Battalion, Keops Kej, Kraljevo

... vazhdon...

Sesionet e Grupeve të përqendrimit

pjesëmarrësit, po ashtu, deklaruan se ata janë të hapur ndaj kthimit dhe se Prizreni ka një histori të gjatë shoqërisë multietnike. Njëri nga pjesëmarrësit theksoi këtë duke deklaruar **“tash shumë gjëra kanë ndryshuar, por shpresojmë që korniza multietnike e Prizrenit një ditë do të riformësohet”**.

Partneri lokal i CRS-së në Serbi, Jug, po ashtu ka zhvilluar grupe të bisedimit – dy në Kragujevc dhe një Krushevc të Serbisë. Në këto grupe të bisedimit udhëheqësit janë zgjedhur nga pjesëmarrësit që t'i përfaqësojnë në GPKP; të zhvendosurit në Kragujevc zgjedhën dy përfaqësues për Grupin Punues të Komunës së Prizrenit (GPKP) me besimin e plotë se këta njerëz do t'i përfaqësojnë interesat e tyre me tërë atë që dijnë më së miri.

Grupi i bisedimeve i mbajtur në Kragujevc përbëhej nga 9 pjesëmarrës të zhvendosur nga qyteti i Prizrenit dhe katër nga fshatrat Sërbica e Epërme dhe Smaç. Sipas Jug-ut, përafërsisht 90 familje të zhvendosura nga Regjioni i Prizrenit jetojnë aktualisht në Kragujevc. Të zhvendosurit pjesëmarrës në këtë

grup bisedimi shprehën interesimin për kthim por theksuan një numër pengesash përfshirë edhe situatën e vështirë shoqërore të të jetuarit si të zhvendosur, qiraja e lartë, siguria, shtëpitë e okupuara dhe prona e shkatërruar dhe pesimizmi për mundësitë e punësimit. Përkundër këtyre shqetësimeve ata spikatën mundësitë që ofron Prizreni – veçanarisht tregu dhe shërbimet të cilat mund të motivojnë edhe të rinjtë për tu kthyer.

Grupi i bisedimeve i mbajtur në Krushevc përfshiu edhe pjesëmarrjen e 12 të zhvendosurve nga Prizreni prej të cilëve tre ishin të rinjë. Përafërsisht 1,000 të zhvendosur nga Rajoni i Prizrenit jetojnë në qytetin e Krushevcit dhe rrethinat e tij. Ky grup ndau pikëpamje të ngjashme me grupin nga Kragujevci sa u përket kthimeve. Megjithatë, ata shtuan se janë shumë të vetëdijshëm se shqiptarët ashtu si edhe bashkësitë e tjera po përgatiten për kthimin e të zhvendosurve. Në fund, një pjesëmarrës deklaroi rëndësinë e bashkëpunimit: **“Kthimi im varet nga fqinjët e mi, nëse ata nuk më duan atje, kthimi nuk do të ndodhë”**.

Grupet Punuese Komunale: Funkzioni dhe roli

Njëra ndër përfundimet kryesore në grupet e bisedimit këtë vit si edhe vitin e kaluar ishte mungesa e tepërt e njohjes me GPKP-në e shprehur si nga të zhvendosurit internë ashtu edhe nga pjesëtarët që jetojnë në bashkësitë e kthimit. Ata deklaruan se ose nuk kanë dëgjuar kurrë për GPKP-në ose e kanë dëgjuar emrin por nuk e dinë funksionin e tij. Informatat në vijim janë siguruar për të zhvendosurit internë dhe bashkësitë e kthimit, ato që kanë zhvilluar projekte për kthimin dhe për përbërësit e tyre:

Grupet Punuese Komunale (GPK-të) përfaqësojnë forumin e koordinimit lokal për projektet e kthimit në Kosovë. Ato sigurojnë zërin dhe dialogun për ata që janë të interesuar në procesin e kthimit dhe mundëson kontaktin e drejtpërdrejtë me organizatat lokale dhe ndërkombëtare sikurse edhe me strukturat qeveritare dhe donatorët. Për më shumë, GPK-të janë të përfaqësuar nga një llojllojshmëri e aksionerëve përfshirë UNMIK-n, zyrtarët lokalë, UNHCR-në, KFOR-in,

SHPK-në, OSCE-n, përfaqësuesit e të zhvendosurve internë dhe OJQ-ve.

Ato kanë tri funksione kryesore:

- Të veprojnë si forum për bashkësi të ndryshme dhe t'i angazhojnë ato në dialogjet e ndërlydhura me procesin e kthimit

- Të punojnë si mekanizëm kryesor, të cilit të zhvendosurit internë mund t'i qasen në lidhje me inkuadrimit në procesin e kthimit dhe po ashtu t'i

kërkojnë ndihmë

- Të jenë trupi qendror i koordinimit për projektet e kthimit dhe qëndrueshmërinë e tyre

Përfaqësuesi Komunal zakonisht kryeson GPK mujor ose dyjavor. Për më shumë, ai/ ajo është përgjegjës për pjesëmarrjen zyrtare të zyrtarëve komunalë dhe zyrtarëve të tjerë të rëndësishëm. Përfaqësuesi sigurohet që GPK të udhëhiqet në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe. Vendimet në GPK arrihen me konsensus. Nëse nuk arrihet konsensusi, atëherë përfaqësuesi komunal mund të vendosë në emër të grupit, duke marrë parasysh, këshillat dhe mendimet e pjesëmarrësve. GPK, po ashtu, mund të caktojë ekipin e projektit për projektet e kthimit, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e implementimit të projektit si edhe ofrimin e përkrahjes partnerëve implementues. Në fund, minutat e GPK-ve janë në dispozicion në gjuhën angleze, shqipe dhe atë serbe sipas kërkesës.



Fotografia: "Fokus grupi ne Krushevc"

Autori: Pjesëmarrësi i projektit